REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

PROJEKT -VENDIM

Nr.40 Datë 27.11.2025

"PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË BASHKISË SARANDË PËR VITIN 2026"

Bazuar në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , neni 9 ,pika 1/1.3 , gërma b, neni 35, pika 4, neni 54 gërma f, Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar , neni 5 gërma b, c dhe ç, neni 7 , neni 9 etj vijim, Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligjin.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.132 datë 07.03.2018 "Për metotologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurive të paluajtshme „ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike , natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës si dhe kritereve dhe rregullave për vlerësësimit alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar, Udhëzimin nr.15 datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportit rrugor" i ndryshuar, Udhëzimin nr.5627 datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe çertidikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit" i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.85 datë 08.02.2017 "Për përcaktimin.e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor" Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.970 datë 02.02.2015"Për përcaktimin e proçedurave dhe kushteve për dhënien e liçensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", si dhe legjislacionit të aplikueshëm në fuqi , akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara , me propozim të Kryetarit te Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratohë hartën e përcaktimit të zonave të Bashkisë Sarande dhe Njësisë Administrative Ksamil për efekt të detyrimeve fiskale , sipas shtojces 1 dhe 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore , Drejtoria e Shërbimeve Publike , Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të

Territorit , Drejtoria e Financës, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Bujqësisë , Veterinarisë, Pyje dhe Kullotave, Drejtoria e Kulturës dhe Shumësporteve dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.143 datë 30.11.2023 "Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2024" dhe çdo vendim që bie ndesh me parashikimet e këtij vendimi, shfuqizohen.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETARI
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
Manjola NIKOLLO

